



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/1082

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Vedat Poterqoi – Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së (OE) “MetBat” SH.P.K., kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit të “KOMUNA E GJAKOVËS” në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit “Asgjësimi i barnave” me numër të prokurimit 632-24-1678-2-2-1, me 16/01/2025, mori:

Vendim

- 1. Aprovohet**, si e bazuar ankesa e OE “MetBat” SH.P.K. me nr. 2024/1082, e datës 08/11/2024, kurse vendimi i AK “KOMUNA E GJAKOVËS” lidhur me aktivitetin e prokurimit “Asgjësimi i barnave” me numër të prokurimit 632-24-1678-2-2-1 anulohet, ndërkaq aktiviteti i prokurimit kthehet në **Rivlerësim**.
2. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.
3. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik “MetBat” SH.P.K.
4. Meqenëse ankesa e OE ankues aprovohet si e bazuar, bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me datën 29.02.2024 “KOMUNA E GJAKOVËS” në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar B05 Njoftimin për Kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit me “Asgjësimi i barnave” me nr. të prokurimit: 632-24-1678-2-2-1. Ndërsa me datën 22.10.2024 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues për dhënie të aktivitetit të prokurimit, OE "PRINCI COMPANY " SH.P.K.- Prishtinë

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të **hapur**, lloji i kontratës: - **shërbim**, vlera e parashikuar e kontratës: **80,000.00 €**.

Me 25.10.2024, OE “MetBat” SH.P.K., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Më 29.10.2024, Autoriteti Kontraktues e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 08/11/2024, OSHP ka pranuar ankesën nga OE “MetBat” SH.P.K., me nr. 2024/1082 për lidhur me aktivitetin “Asgjësimi i barnave” me nr. të prokurimit: 632-24-1678-2-2-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “MetBat” SH.P.K., janë parashtruar si në vijim:

Të nderuar ne me dt. 22.10.2024 kemi pranuar njoftimin mbi vendimin e AK-së, ku edhe pas rivlerësimit të katërt përsëri është rekomanduar për kontratë përsëri OE PRINCI COMPANY SH.P.K, ndërsa ne jemi eliminuar me arsyetimin si në vijim:

Fillimisht duhet të sqarojmë se në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit autoriteti kontraktues kishte publikuar njoftimin mbi vendimin e saj të parë me dt. 12.04.2024, ku ishte rekomanduar për kontratë OE Princi Company SHPK, ndërsa kundër vendimit të lartcekur ne kishim parashtruar kërkesë për rishqyrtim të cilën AK-ja e kishte aprovuar si pjesërisht të bazuar dhe e kishte kthyer lëndën në rivlerësim. Pas rivlerësimit me dt.20.05.2024 AK-ja ka publikuar përsëri njoftimin mbi vendimin e saj ku tani na kishte rekomanduar për kontratë neve si OE i përgjegjshëm dhe me çmim më të lirë. Kundër këtij vendimi ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim OE tani i rekomanduar për kontratë, të cilit AK-ja ja kishte aprovuar kërkesën për rishqyrtim pjesërisht dhe lëndën e kishte kthyer në rivlerësim përsëri. Me dt.30.09.2024 në vendimin e parafundit AK-ja përsëri e kishte rekomanduar për kontratë OE Princi Company SHPK, ndërsa neve përsëri na kishte eliminuar me arsyetimin se AK-ja ka kërkuar licencë dhe jo leje mjedisore.

Kundër vendimit të lartcekur ne kishim parashtruar kërkesë për rishqyrtim të cilën AK-ja e ka aprovuar si pjesërisht të bazuar dhe lëndën e kishte kthyer në rivlerësim. Tani pas rivlerësimit përsëri autoriteti kontraktues na ka eliminuar me arsyetimin e njëjtë sikurse në vendimin e dt.30.09.2024, andaj ne përsëri jemi të detyruar të parashtrojmë këtë kërkesë për rishqyrtim, pasi që po eliminohe mi padrejtësisht dhe njëkohësisht në këtë tender po përdoren standarde të dyfishta në raport me ne dhe OE të rekomanduar për kontratë.

Arsyetimi i autoritetit kontraktues është i pa bazuar dhe i paqëndrueshëm dhe këtë gjë ne e kemi sqaruar edhe në kërkesën për rishqyrtim të dt.16.04.2024 dhe dy kërkesat tjera të cilat siç e cekëm AK-ja i kishte aprovuar si pjesërisht të bazuara, mirëpo edhe përkundër këtij fakti ne edhe një herë po i parashtrojmë faktet tona, të cilat e vërtetojnë se vendimi i AK-së është i pa bazuar. Ju njoftojmë se me LIGJIN NR. 08/L-071, PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR.04/L-060 PËR MBETURINA i publikuar me dt.01.09.2022 në gazetën zyrtare, përkatësisht tek neni 39 i këtij ligji paragrafët 1, 2 dhe 3 është specifikuar qartë se “Titulli i KREUT VIII, të ligjit bazik, “Licenca për Menaxhimin e Mbeturinave”, zëvendësohet me titullin “Leja përkatëse Mjedisore”. 2.Titulli i nenit 55, të ligjit bazik, “Licenca për menaxhimin e mbeturinave” zëvendësohet me titullin “Leja Përkatëse Mjedisore” 3. Në nenin 55, të ligjit bazik, paragrafi 1, ndryshohet dhe plotësohet si në vijim: 1. Operatorët që menaxhojnë mbeturinat duhet të pajisen me leje përkatëse mjedisore”.

Pra, titulli licencë është zëvendësuar me titullin leje mjedisore, prandaj edhe vetë kërkesa që të ofrohet licencë nuk përkon me këtë plotësim ndryshim të Ligjit, mirëpo si do që të jetë leja mjedisore që ne e kemi bashkangjitur me ofertë e ka mbuluar edhe licencën, pra leja mjedisore ka qenë dokument edhe më i fuqishëm dhe më i rëndësishëm se sa licenca, pasi që leja mjedisore e prezantuar nga ne e posedon te integruar licencën. LIGJIN NR. 08/L-071, PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR.04/L-060 PËR MBETURINA të publikuar me dt.01.09.2022 po e citojmë më poshtë vetëm si sqarim se titulli/fjala licencë është zëvendësuar me titullin/fjalën leje përkatës mjedisore, e të cilën leje ne e kemi bashkangjitur me ofertë.

Pra, me këtë ndryshim plotësim të Ligjit për mbeturina nuk lëshohet licencë por leje mjedisore dhe ky Ligj është publikuar në gazetën zyrtare me dt.01.09.2022, kurse njoftimi për kontratë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit është bërë me dt. 29.02.2024. Në ligjin NR.04/L-060 PËR MBETURINA konkretisht nenin 55 paragrafi 2 ka qenë e shënuar që “Licenca për menaxhimin e mbeturinave nuk do të lëshohet për operatorët që operojnë në objektet dhe impiantet, të cilat janë të detyruar të i nënshtrohen procedurës për marrjen e lejes integruar mjedisore sipas Ligjit për Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar të Ndotjes”. Nga Ligji i lartpërmendur, kuptohet qartë, që kompanitë të cilat e kanë poseduar lejen mjedisore nuk është dashur të pajisen me licencë, sepse realisht leja e integruar mjedisore e ka mbuluar licencën. Pra veprimtaritë që i përmban licenca janë të përfshira në lejen e integruar mjedisore, prandaj më rëndësi është fakti se ne si kompani që kemi leje mjedisore të integruar kemi (dhe kemi pasur) të drejtë të bëjmë asgjësimin e mbeturinave spitalore, medicinale, organike të përgjithshme dhe me këtë rast nuk mund të konsiderohemi të papërgjegjshëm në këtë aktivitet të prokurimit sepse Licenca e kërkuar është e

mbuluar me Lejen mjedisore të integruar dhe në këtë rast është dashur të llogaritet e barasvlershme me licencën. Prandaj edhe mbi këtë bazë dhe me këtë argumentim dhe arsye është nxjerr edhe LIGJI NR. 08/L-071, PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR.04/L-060 PËR MBETURINA i publikuar me dt.01.09.2022, e ku është hequr tërësisht titulli licencë dhe është zëvendësuar me titullin leje mjedisore. Ne, në një rast më herët kishim kërkuar sqarime nga MMPHI dhe kishim marr përgjigje si në vijim:

Nëse keni pasur dilema në lidhje me lejen mjedisore dhe të drejtën tonë për asgjësimin e mbeturinave spitalore, medicinale, organike të përgjithshme, lirisht është dashur ti drejtohuni MMPHI dhe të merrni përgjigje zyrtare nga ky institucion. Edhe tani kërkojmë nga AK-ja, që ti drejtohet MMPHI në lidhje me këtë çështje, me qëllim që të pranoj përgjigje zyrtare dhe konkrete. MMPHI është institucion kompetent, prandaj përgjigja zyrtare e tyre do të i ndihmojë edhe AK-së në vendimmarrje.

Andaj duke u bazuar në faktet e lartcekura kuptohet qartë se ne jemi OE i përgjegjshëm dhe me çmim më të lirë në këtë aktivitet të prokurimit, andaj nuk mund dhe nuk duhet të eliminohemi me arsyetime të tilla siç i keni dhënë ju. Sa për sqarim, në ekspertizën nr.2023/0249 e dt.14.05.2023 të lëshuar nga Eksperti Shqyrtues Bujar Lushaku në një ankesë tjetër të parashtruar nga kompania jonë në lidhje me aktivitetin prokurimit “Asgjësimi i barnave me afat të skaduar nëpër njësitë shëndetësore të burgjeve me Nr. prok:206-23-2160-2-2-1, iniciuar nga Ministria e Shëndetësisë, është cekur si në vijim:

Eksperti shqyrtues në këtë rast e ka cekur qartë se leja e integruar mjedisore është e barasvlershme me licencën, edhe pse ne e potencojmë që licenca është në kuadër të lejes së integruar mjedisore. Po ashtu eksperti shqyrtues me të drejtë e ka cekur se nëse ka hezitim nga AK-ja mund të kërkojë sqarim dhe informacione nga lëshuesit e atyre dokumenteve, prandaj edhe ju në këtë rast duhet të kërkonit sqarim dhe informata nga MMPHI. Pra ne ju inkurajojmë që të kërkonit sqarime shtesë në lidhje me lejen e integruar mjedisore që ne e kemi ofruar. Duhet cekur fakti se ne si kompani kishim parashtruar ankesë në lidhje me aktivitetin prokurimit “Asgjësimi i mbetjeve medicinale dhe barnave me afat të skaduar me Nr. prok: 632-23-6728-2-2-1, iniciuar nga vet ky autoritet kontraktues Komuna e Gjakovës, ndërsa në Vendimin nr. 2023/0536 të dt.04.09.2023 është obliguar autoriteti kontraktues që të ndryshojë dosjen e tenderit dhe të përcaktohet në dosje të tenderit edhe leja mjedisore, prandaj ekziston praktikë e vendimmarrjes nga OSHP-ja në lidhje me këto kërkesa dhe raste. Sidoqoftë leja e integruar mjedisore në secilin variant mund të konsiderohet ekuivalente me licencën, prandaj duhet pasur parasysh këtë fakt dhe nuk duhet të diskriminohemi ne si kompani në këtë rast. Thjesht kërkojmë që të kemi një trajtim të barabartë të dokumenteve në raport me të gjithë ofertuesit. Autoriteti kontraktues gjatë rivlerësimit të ofertave ka përdorur standarde të dyfishta dhe këtë gjë do të sqarojmë në vijim:

OE i rekomanduar për kontratë, në momentin që ka ofertuar ka prezantuar licencë mirëpo tani afati i licencës i ka skaduar dhe tani ky OE posedon leje mjedisore e cila i është lëshuar me dt.24.05.2024 pasi që licenca më nuk lëshohet sipas ligjit të lartcekur. Në këtë rast OE i

rekomanduar për kontratë në asnjë mënyrë nuk mund ta prezantoj licencën për asgjësimin e produkteve të këtij aktiviteti të prokurimit, mirëpo do ta prezantoj vetëm lejen mjedisore. Autoriteti kontraktues është dashur ta ketë parasysh faktin se afati i licencës së prezantuar nga OE i rekomanduar për kontratë ka skaduar dhe është dashur të kërkoj sqarime nga i njëjti me qëllim që ta prezantoj licencën me afat të vazhduar, mirëpo një gjë të tillë nuk e ka bërë. Ne së bashku me këtë kërkesë për rishqyrtim po e bashkangjesim lejen mjedisore të OE të rekomanduar për kontratë, të cilën e kemi siguruar nga aktivitetet tjera ku kemi aplikuar dhe kemi pasur qasje në dokumentet e këtij OE. Përderisa po rekomandohet për kontratë një OE i cili tanimë nuk posedon licencë por leje mjedisore, ndërsa po eliminohe mi ne si kompani ku e posedojmë lejen mjedisore të integruar e cila gjithashtu e ka të integruar edhe licencën, atëherë këtu shihet qartë standardet e dyfishta, pasi që po eliminohe mi ne si OE i përgjegjshëm dhe me çmim më të lirë, ndërsa po rekomandohet një OE i cili ka ofertuar me çmim më të lartë se sa ne. Ne kemi pasur qasje në ofertën e OE të rekomanduar për kontratë dhe gjithashtu edhe në sqarimet që AK-ja i ka bërë gjatë rivlerësimit, ku e kemi vërejtur që AK-ja i ka kërkuar sqarimet të njëjtit, si në vijim:

OE i rekomanduar për kontratë me dt.14.10.2024 i ka kthyer përgjigje AK-së, mirëpo në përgjigjen e tij i njëjti askund dhe në asnjë mënyrë nuk e sqaron se a i është vazhduar apo jo validiteti i licencës (Një gjë e tillë nuk ka mundur të ndodh pasi që tani me ligjin e lartcekur nuk lëshohet licenca). I njëjti OE në sqarimet e tij e ka cekur se:

Kjo përgjigje e të njëjtit është vetëm aprovim i asaj të cilës pretenduam më lartë, sepse në asnjë mënyrë nuk mund të dëshmohet që licencës i është vazhduar validiteti. OE i rekomanduar për kontratë e ka cekur se nuk ka kurrfarë lidhje validiteti i licencës, mirëpo një arsyetim i tillë nuk qëndron, sepse nëse licenca nuk posedon validitet atëherë nuk mund të kryhet asgjësimi i barnave. Për ne është e habitshme se si autoriteti kontraktues e ka marr parasysh përgjigjen e OE të rekomanduar për kontratë ku i njëjti edhe pse nuk ka prezantuar dëshmi sipas kërkesës së AK-së, përsëri është rekomanduar për kontratë. Përderisa nuk është prezantuar licenca me afat të vazhduar shihet qartë se OE i rekomanduar është i papërgjegjshëm sepse i njëjti nuk mund ta bëj asgjësimin e barnave. Sa i përket ligjit të cilit i është referuar në njoftim mbi vendimin e saj, ju sqarojmë se nëse analizohet në detaje leja mjedisore e integruar e prezantuar nga ana jonë, shumë qartë se ne jemi të pajisur me leje për asgjësim të mbeturinave spitalore, medicinale, organike të përgjithshme etj. Pra asnjëri nga arsyetimet e AK-së për eliminimin tonë nuk është i qëndrueshëm, andaj kërkojmë që të analizohen në tërësi të gjitha dokumentet tona dhe të OE të rekomanduar për kontratë dhe të nxjerrët një vendim meritör.

Andaj duke u bazuar në të gjitha faktet e lartcekura kuptohet qartë se ne e përmbushim kërkesën e dosjes së tenderit dhe arsyetimi i autoriteti kontraktues është i paqëndrueshëm dhe diskriminues për ne si kompani. 10/6 Ne me dt.29.10.2024 kemi pranuar vendimin për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, me arsyetimin se e njëjta është e pa bazuar, mirëpo që vendimi nuk është arsyetuar dhe nuk është mbështetur në asnjë dispozitë ligjore. Autoriteti kontraktues në vendimin e saj ka dhënë arsyetimin si në vijim:

Nga të gjitha faktet që kemi dhënë në kërkesën për rishqyrtim dhe për më tepër kur të njëjtat pretendime vet autoriteti kontraktues në vendimet e saj i kishte aprovuar si të bazuara, tani për ishte aprovuar si të bazuara, tani për çudi në këtë vendim nuk ka dhënë asnjë arsyetim konkret, në lidhje me pretendimet tona ankimore. Pasi që autoriteti kontraktues nuk ka mundur të argumentoj të kundërtën e pretendimeve tona ankimore, e njëjta është arsyetuar vetëm me një fjali se kinse dëshmitë tona nuk përkojnë me kërkesat e autoritetit kontraktues. Ndërsa e njëjta nuk i ka marr parasysh fare pretendimet tona ankimore se në këtë aktivitet të prokurimit po përdoren standarde të dyfishta ku po favorizohet OE i rekomanduar për kontratë, ndërsa po diskriminohemi ne si OE i përgjegjshëm dhe me çmim më të lirë në këtë aktivitet të prokurimit. Veprimi i autoritetit kontraktues është në kundërshtim me dispozitat e nenit 108/A të LPP-së paragrafi 9 ku specifikohet qartë si në vijim “9. Refuzimi do të arsyetohet dhe do ti komunikohen me shkrim, në përputhje me këtë ligj, parashtuesit të ankesës dhe të gjitha palëve të interesuara, nëse ka ndonjë. Për më tepër autoriteti kontraktues mund të pengojë procedurën e mëtejshme, me pranimin e një njoftimi me shkrim nga ankuesi në lidhje me gatishmërinë e tij për të tërhequr kërkesën e paraqitur për shqyrtim”. Kërkojmë nga ana e OSHP-së që të caktoj një ekspert teknik i cili është ekspert i kësaj çështje me qëllim që të vërtetohet gjendja faktike dhe gjithashtu kërkojmë nga OSHP që të analizoj në detaje pretendimet tona ankimore dhe të nxjerr një vendim meritore në lidhje me ankesën tonë. Gjithashtu kërkojmë që të caktohet seancë për ankesën tonë, me qëllim që ti ofrojmë panelit shqyrtues faktet dhe dëshmitë e nevojshme, për të vërtetuar gjendjen faktike. Duke u bazuar në të gjitha faktet e lartcekura kuptohet qartë se vendimi i AK-së për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim është i pa bazuar dhe i pa mbështetur në dispozita ligjore.

Duke u bazuar në dëshmitë dhe faktet që u cekën më lartë rezulton se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës, e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët sipas neni 60 paragrafi 1.1 i LPP-së. Gjithashtu nuk është respektuar edhe neni 7 i LPP-së, sepse jemi diskriminuar ne duke mos na shpallur fitues edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë. Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që “Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente”. Në këtë rast nuk është respektuar as neni 6 ekonomikiteti sepse është eliminuar pa bazë ligjore oferta me çmim të ulët, kurse në këtë rast dëmtohet buxheti i shtetit. Nuk është marr në konsideratë edhe neni 1 i LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve 11/6 publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Duke u referuar pretendimeve si më sipër “MetBat” SH.P.K., konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim Neni 1 i LPP-së, Neni 6 i LPP-së, Neni 7 i LPP-së, Neni 59 i LPP-së, Neni 60 i LPP-së, Neni 64 i LPP-së, Neni 69 i LPP-së, Neni 72 i LPP-së, LIGJI NR. 08/L-071, PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR.04/L060 PËR MBETURINA.

Përgjigje e AK ne kërkesën për rishqyrtim: Operatori Ekonomik "MetBat" SH.P.K., me dt.25.10.2024, ka parashtuar kërkesës për ri- shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit

“Asgjësimi i bamave”, Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-24-1678-2-2-1, Nr. i brendshëm- 632-24-018-221. Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 29.10.2024, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë: Dëshmitë e ofruara nga ju nuk përkojnë me kërkesat e Autoritetit kontraktues në FDT-ë.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 15.11.2024 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 1082/2024, ndërsa me datë 23.11.2024 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2024/1082 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK Nuk pajtohet me rekomandimin e ekspertit, ndërsa OE pajtohet rreth raportit të ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtrësat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritore lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtrësat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE “MetBat” SH.P.K., - eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2024/1082 ka vlerësuar si në vijim:

Përmbledhje e Ankesës: Objekti i ankesës: Aktiviteti i prokurimit për "Asgjësimin e barnave" nga Komuna e Gjakovës, me numër të prokurimit “632-24-1678-2-2-1”. Arsyeimi i ankesës: Operatori ekonomik ankues pretendon se autoriteti kontraktues (AK) – Komuna e Gjakovës ka bërë shkelje të dispozitave të LPP-së dhe ka përdorur standarde të dyfishta, duke eliminuar padrejtësisht ofertën e tij të përgjegjshme dhe më të lirë. AK ka eliminuar kompaninë MetBat SH.P.K. nga aktiviteti i prokurimit me pretendimin se nuk ka ofruar dokumentin e kërkuar - "licencën për menaxhimin e mbeturinave". OE ankues ka argumentuar se, sipas Ligjit Nr. 08/L-071 për Mbeturinat, i publikuar më 01.09.2022, termi "licencë" është zëvendësuar me "leje mjedisore", duke e bërë kërkesën për licencë të pavlefshme dhe jashtë kontekstit të ligjit të tanishëm. Sipas OE - MetBat SH.P.K. leja mjedisore e integruar, e paraqitura në ofertë, është dokument gjithëpërfshirës që mbulon plotësisht funksionet e kërkuara nga licenca.

OE ankues gjithashtu pretendon se, AK ka favorizuar Operatorin Ekonomik Princi Company SH.P.K., i cili:

1. Ka ofertuar me çmim më të lartë.
2. Nuk posedon një licencë valide, pasi ajo ka skaduar.

“MetBat SH.P.K pretendon se, vendimi i AK-së shkel nenet 6, 7, 59 dhe 60 të LPP-së dhe se procesi ka dëmtuar buxhetin e shtetit duke përzgjedhur një ofertë më të shtrenjtë.

Kërkesa e AK për licencën për menaxhimin e mbeturinave:

AK në FDT në Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, ka kërkuar Licencën për menaxhimin e mbeturinave e lëshuar nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës - MMPHI të Republikës së Kosovës.

Gjetjet dhe konkluzionet e ekspertit shqyrtues:

AK ka krijuar një seri vendimesh të përsëritura dhe të ndryshuara gjatë këtij procesi të prokurimit. Në vijim gjeni kronologjinë e vendimeve të AK-së:

Eksperti shqyrtues pas analizimit të dokumenteve lidhur me pretendimet ankimore të OE ankues ka gjetur se, sipas Ligjit Nr. 08/L-071 për Mbeturinat, "licenca për menaxhimin e mbeturinave" është zëvendësuar me "leje mjedisore". Ky ligj është publikuar në gazetën zyrtare me datë 01.09.2022.

Për të shmangur çfarë do dileme lidhur me pretendimet ankimore eksperti shqyrtues ka kontaktuar zyrtarë përgjegjës në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), të cilët kanë pohuar se me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr. 08/L-071 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr. 04/L-060 për mbeturina, ky institucion nuk lëshon më licenca por vetëm leje përkatëse mjedisore: “Me hyrjen në fuqi të ligjit të ri titulli licencë është zëvendësuar me titullin leje mjedisore dhe ne si ministri nuk lëshojmë më licenca por leje përkatëse mjedisore, ashtu siç përcaktohet në ligj”, ka deklaruar Z. Abdullah Pirçe, UD Drejtor i Departamentit për Mbrojtjen e Mjedisit në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, duke shtuar se operatorët ekonomik të cilët janë të pajisur me licenca të njëjtat vlejnë vetëm deri në skadim dhe duhet të zëvendësohen me leje sipas ligjit.

Mbështetur në të gjeturat e lartcekura eksperti shqyrtues konstaton se, leja mjedisore e “MetBat” SH.P.K. është dokument i vlefshëm dhe mbulon të gjitha funksionet e kërkuara sipas ligjit në fuqi dhe përgjigjeve të zyrtarëve përgjegjës të MMPHI-së dhe është e barasvlershme me licencën e kërkuar nga AK.

Po ashtu në Ligjin për Prokurim Publik dhe sidomos në Rregulloren Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, Neni 25. Kriter e përzgjedhjes thuhet:

“Në raste kur lëshimi i dokumenteve ose certifikatave, nën kërkesat e përshtatshmërisë ose përshtatjes profesionale nuk janë të arritshme për arsye objektive, ose kur këto dokumente nuk mbulojnë të gjitha rastet për të cilat evidenca duhet të prodhohet, një deklaratë e shkruar në

betim nga OE mund të pranohet si evidencë e mjaftueshme. Pavarësisht nga neni 65 i LPP –së dhe Neni 66 i LPP-se.”

Eksperti shqyrtues gjatë analizimit të dokumenteve po ashtu ka gjetur se, AK ka rekomanduar për dhënie të kontratës një OE i cili ka ofertuar me një çmim më të lartë dhe licenca e të cilit tashmë ka skaduar dhe të njëjtën duke ta zëvendësojë me leje mjedisore sipas ligjit në fuqi dhe të njëjtë me lejen mjedisore që ka dorëzuar OE – “MetBat” SH.P.K..

Sipas dokumenteve të dorëzuara me ofertë licenca për administrimin e mbeturinave e OE - Princi Company SH.P.K. ka skaduar me datë 26.05.2024. Madje në një kërkesë për sqarim të tenderit OE i rekomanduar për dhënie të kontratës nuk i është përgjigje konkretisht kërkesës së AK-së lidhur me licencën e skaduar, duke pohuar se vazhdimi i saj apo jo është çështje e tyre dhe jo e AK-së, duke anashkaluar kështu një përgjigje konkrete.

Eksperti shqyrtues i rikujton AK-së se në pajtim me nenin 7 të LPP-së është i obliguar ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe të mos krijoj avantazh të padrejtë për një OE të caktuar. Po ashtu me qëllim të ruajtjes së parasysh publike, gjatë administrimit të procedurave të prokurimit, duhet të ketë parasysh nenin 6 të LPP-së që përcakton se: ”Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit”.

Përzgjedhja e një operatori ekonomik me një ofertë me çmim më të lartë, pa një arsyetim të qartë ligjor, përbën një shkelje të parimeve të prokurimit publik. AK kriter për dhënie të kontratës ka përcaktuar çmimin më të ultë dhe është i detyruar ta respektojë atë.

Rekomandimet për Panelin Shqyrtues: Duke u bazuar në sqarimet e mësipërme eksperti shqyrtues rekomandon panelit shqyrtues se lënda të kthehet në rivlerësim dhe AK– Komuna e Gjakovës gjatë rivlerësimit të ketë parasysh nenin 6 dhe nenin 7 të LPP-së dhe vlerësimin të bëhet në harmoni me parimet themelore të LPP-së, duke garantuar trajtim të barabartë dhe transparencë.

Sipas të thënave më sipër, eksperti shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive të pretendimet e operatorit ekonomik ankues “MetBat” SH.P.K., Argumentimi në raportin e ekspertit shqyrtuese është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat kanë ofertuar tenderuesit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertit. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues “MetBat” SH.P.K., janë të bazuara.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Bazuar në shkresat e kësaj lënde, Paneli konsideron se lidhur me çështjen në rastin konkret, ka pasur nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, në kuptim të nenit 24 paragrafit 1 të

Rregullores së Punës së OSHP, duke marrë parasysh faktin që pretendimet e palëve dhe parashtrësas e tyre, provat si dhe raportin e ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i hartuar me kërkesën e Panelit lidhur me kontestin në këtë lëndë të aktivitetit të prokurimit publik, përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë Panelin dhe të gjitha palët në konteste me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore.

Mirëpo duhet theksuar faktin ligjor se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Panelin shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjera, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit, prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, raportin e ekspertit dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjyqimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse I adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të Ligjit të Prokurimit Publik.

Rrjedhimisht eksperti shqyrtues profesional i ka analizuar në detaje të gjitha shkresat e lëndës dhe ka vepruar konform autorizimve të tij/saj, me çrast për të shmangur çfarë do dileme lidhur me pretendimet ankimore eksperti shqyrtues ka kontaktuar zyrtarë përgjegjës në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), të cilët kanë pohuar se me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr. 08/L-071 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr. 04/L-060 për mbeturina, ky institucion nuk lëshon më licenca por vetëm leje përkatëse mjedisore: “Me hyrjen në fuqi të ligjit të ri titulli licencë është zëvendësuar me titullin leje mjedisore dhe ne si ministri nuk lëshojmë më licenca por leje përkatëse mjedisore, ashtu siç përcaktohet në ligj”, ka deklaruar Z. Abdullah Pirçe, UD Drejtor i Departamentit për Mbrojtjen e Mjedisit në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, duke shtuar se operatorët ekonomik të cilët janë të pajisur me licenca të njëjtat vlejnë vetëm deri në skadim dhe duhet të zëvendësohen me leje sipas ligjit.

Po ashtu eksperti shqyrtues ka konstatuar se Sipas dokumenteve të dorëzuara me ofertë licenca për administrimin e mbeturinave e OE - Princi Company SH.P.K. ka skaduar me datë 26.05.2024. Madje në një kërkesë për sqarim të tenderit OE i rekomanduar për dhënie të kontratës nuk i është përgjigje konkretisht kërkesës së AK-së lidhur me licencën e skaduar, duke pohuar se vazhdimi i saj apo jo është çështje e tyre dhe jo e AK-së, duke anashkaluar kështu një përgjigje konkrete.

Paneli shqyrtues vlerëson se eksperti shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive pretendimet e operatorit ekonomik ankues MetBat SH.P.K. dhe se Argumentimi në raportin ekspertit me nr. 2024/ 1082 është mjaftë i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht në dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat kanë ofertuar tenderuesit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorëve ekonomik ankues i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertit. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e operatorëve ekonomik ankues të lartpërmendur janë të bazuara dhe aktiviteti i prokurimit “Asgjësimi i barnave” me numër të prokurimit: “632-24-1678-2-2-1, të iniciuar nga Autoriteti

Kontraktues (AK) – KOMUNA E GJAKOVËS, duhet të kthehet në ri-vlerësim.

PSH duke u bazuar në konstatimet e ekspertit shqyrtues dhe në pretendimet ankimor të cilat janë mjaftë të argumentuara me prova dhe fakte bindëse, rezulton se AK nuk ka vepruar konform nenit 7, 59 dhe 60 të LPP.

Bazuar në të lartcekurat, Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në këtë rast përbëjnë bazë të mjaftueshme që aktivitetit i prokurimit të kthehet sërish në ri-vlerësim.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 dhe 31 paragrafin të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 131 të LPP lidhur me nenin 29 paragrafin 3 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën IV të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KOMUNA E GJAKOVËS**
- **OE - MetBat SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: